

**VENDIM**  
**Nr. 833, datë 24.12.2021**

**PËR MËNYRËN E NGRITJES, ADMINISTRIMIT, MIRËMBAJTJES SË BAZËS SË TË DHËNAVE PËR RININË, SI DHE MËNYRËN E NDËRVEPRIMIT TË SAJ ME BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE SHETËTËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të pikës 4, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin dhe funksionimin e bazës së të dhënave për rininë, si regjistër elektronik për rininë (në vijim, RER).

2. Agjencia Kombëtare për Rininë (në vijim “AKR”), si institucioni përgjegjës për rininë, administron RER-in dhe është dhënësi i informacionit, në kuptim të legjislacionit për bazat e të dhënave shtetërore.

3. Të dhënat që përmban RER-i ndahen në të dhëna parësore dhe në të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore do të konsiderohen:

i. numri i aplikimit nga Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, organizata rinore dhe për të rinjtë, në vend apo në diasporë, për regjistrim në RER;

ii. numri i regjistrimit në RER të Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore, organizatave rinore dhe për të rinjtë, në vend apo në diasporë;

iii. të dhëna për politikatat rinore kombëtare, të miratuara në fushën e planifikimit strategjik rinor (në rast se ka);

iv. të dhëna për politikatat rinore vendore (në rast se ka);

v. të dhëna për politikatat rinore evropiane (në rast se ka).

b) Të dhëna dytësore konsiderohen ato të dhëna që përfshijnë:

i. të dhënat e regjistrimit gjyqësor në lidhje me organizatat jofitimprurëse, për numrin dhe datën e regjistrimit të subjektit, llojin (formën e organizimit) e organizatës jofitimprurëse, emrin e subjektit, fushën e veprimtarisë dhe misionin e tij;

ii. të dhënat e regjistrimit tregtar për datën e regjistrimit të subjektit, emrin e subjektit/shoqërisë tregtare, numrin unik të identifikimit të subjektit, llojin e shoqërisë tregtare (formën e organizimit të saj), fushën e veprimtarisë dhe misionin e tij/saj, statusin e tij;

iii. të dhënat e regjistrave që lidhen me studime, analiza, vlerësime, vëzhgime dhe vlerësime të zbatimit të politikave rinore (në rast se ka);

iv. të dhënat e regjistrave që kanë të bëjnë me financimin e projekteve dhe veprimtarive rinore (në rast se ka).

Të dhënat dytësore të mësipërme trajtohen si informacion konfidencial, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të posaçëm, për aq sa trajtohen si të tilla prej tij. Përdorimi i tyre është i lejuar vetëm për punonjësit e AKR-së, që përdorin bazën e të dhënave.

4. Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave të grumbulluara bazohet në:

a) parimin e ndershmërisë, të drejtësisë dhe të ligjshmërisë;

b) grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë dhe në përputhje me këto qëllime;

c) saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta të ndryshohen ose të rregullohen;

ç) garantimin e masave teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose

përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi;

d) kryerjen e çdo veprimi në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave etj., duke lënë gjurmë me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave;

dh) mbajtjen e të dhënave që lejojnë identifikimin e subjekteve (organizatave rinore dhe për të rinjtë) për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin janë regjistruar.

5. Të dhënat e mbledhura nga RER-i mund të përdoren për kërkime shkencore e statistikore, analiza, vlerësime apo projekte të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Të dhënat e RER-it përditësohen periodikisht nga AKR-ja, sa herë është e nevojshme apo ka ndryshime të këtyre të dhënave.

7. Niveli i aksesimit në sistemin për personat e interesuar të bazës së të dhënave RER është, si më poshtë vijon:

a) Të rinjtë, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë dhe Organizata Kombëtare Përfaqësuese për Rininë kanë nivel aksesit si lexues të RER-it e dërgues të kërkesave për informacion publik, nëpërmjet portalit “Për rininë”;

b) AKR-ja ka akses si administrator dhe përdorues i RER-it. Niveli i aksesimit, funksionet e të drejtat për secilën kategori përdoruesi të sistemit janë në përputhje me pozicionin e punës së punonjësit të AKR-së.

8. Baza e të dhënave të RER-it ndërvepron nëpërmjet shkëmbimit elektronik të të dhënave me:

a) bazën e të dhënave të regjistrimit gjyqësor për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (OJF-ve);

b) bazën e të dhënave të regjistrimit tregtar;

c) bazën e të dhënave të informacionit të planifikimit të integruar – SIPI.

9. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Agjencia Kombëtare për Rininë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**